ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **NP"TERMOKOS"Sh.a**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **TER-023-055-2.2.1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Shërbime për përfaqesime dhe konsulenc ligjore**

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GOE Shala&Assocates Sh.P.K, Betim Shala B.I, Avokat Arbër Shala B.I

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Xhim Xhema K.5, nr.26
(Adresa)
Prishtine
(Vendi)
044889977
(Numri Telefonit)

10000
(Kodi postar)
n/a
(Numri i Faks-it)

Arbër Shala
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
infoshala.laë@gmail.com
(Adresa elektronike)

26.04.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara Shala & Associates +383 (0) 44 88 99 77 infoshala.law@gmail.com Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

__*n/a*_____
(Emri i avokatit)

____*n/a*_____
(Adresa e plotë)

____ *n/a* _____
_____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*
n/a
_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Aktiviteti I prokurimit eshte dërguar me date 10.11.2023, dhe njoftimi me date 13.11.2023 ne patformen e-prokurimi, me titull; Shërbime për përfaqesime dhe konsulenc ligjore, me numer te prokurimit TER-023-055-2.2.1, Vlera e parashikuar: 50,000.00 Euro. Afati i fundit për dorëzim është:04.12.2023 në ora 13:00:00 Vendi: NP"TERMOKOS"Sh.a, Tenderet duhet te dorzohen vetem ne Forme elektronike, permes platformes se e-prokurimit. Hapja e tendereve me date 04.12.2023 në ora 13:30:00 Vendi: NP"TERMOKOS"Sh.a . Kriteri I Dhënies se kontrates - Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	**x**	

n/a

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	**x**				**Jo**		

Kemi paraqitur kerkesen per rishqyrtim te dates 22.04.2024, e cila eshte refuzuar me date 24.04.2024.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 par 1 dhe 2 të LPP-së

Neni 2 të LPP-së

Neni 7 të LPP-së

Neni 24 par 2 dhe 3 të LPP-së

Nenit 56 të LPP-së

Neni 59 të LPP-së

Neni 60 par 1.1 të LPP-së

Neni 68 të LPP-së

Neni 69 të LPP-së

Neni 30 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 38 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 39 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 40 par 3 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 40 par 6 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 40 par 8 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 45 par 16 të Rregullores 001/2022 për PP

Neni 6 të LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 40 Rr.UOPP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteri për Dhënien e Kontratës

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 48 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me vendimin e OSHP: **2024/0091, të datës 21.03.2023**, eshte aprovuar si e bazuar ankesa e OE Shala&Associates Sh.P.K, dhe vendimi I AK-Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A lidhur me aktktivitetin e prokurimit: NP Termokos Sh.a 23-12588-2-2-1 anlulohet, ndersa aktiviteti I prokurimit kthehet ne ri-vlersim.

Pas ketij vendimi te OSHP OE Shala&Associates Sh.P.K perms emailit te dates 29.03.2024, I eshte drejtuar AK Termokos Sh.A dhe I ka kerkuar zbatimin e ketij vendimi duke e basjkangitur dhe deklaraten per zgjatje te validitetit te ofertes si dhe deklaraten e KS elsig per sigurine e tenderit, te cilat I ka bashkangjitur edhe ne platformen e -prokurimi.

AK – NP.Termokos Sh.A, më datë 18.04.2024, anulon përsëri e anulon aktivitetin e prokurimit dhe përmes letrës standarde e njofton OE: Shala&Assocates Sh.P.K se oferta është e papërgjegjshme për

shkak se nuk i është përgjigjur letrës standarde kërkesës për sqarimin e dosjes së tenderit për zgjatje të vlefshmërisë së tenderit dhe sigurisë së tenderit brenda afatit të cekur në letrën standarde.

OE Shala&Associates Sh.P.K, më datë 22.04.2024, paraqet kërkesën për rishqyrtim duke parqitur të gjitha faktet dhe argumentet lidhur me njoftimin e AK.

AK më datë 24.04.2024, e refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

AK me rastin e reuzimit të kërkesës për rishtyrtim dhe njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit përkundër faktit që nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP:2024/0091, të datës 21.03.2024, nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së, për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vapuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke shkelur edhe nenin 40 par 3 të rregullores Nr.001/2022, për PP, si dhe duke mos zbatuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit me numër **OSHP: 2024/0091, të datës 21.03.2023,** pas që nga data e hapjes e vendimi të OSHP-së, e deri më datë 18.04.2024, si datë e njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, AK ka tejkaluar afatin kohor për periudhën e vlerësimit të tenderëve sipas dispozitës së lartcekur Ligjore dhe afatit 10 ditor të përcaktuar me pikën 2 të dispozitivit të vendimit t**ë OSHP: 2024/0091, të datës 21.03.2023.**

Po ashtu AK komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së

Neni 1

Qëllimi 1.

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6

Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

AK komisioni i Ri-vlerësimit dhe ZPP-ja kanë shkelur dispozitat e LPP-së me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, ne raportin e vlerësimit dhe letrën standarde të eliminimit, po citojmë:

Komisioni i ri-vlerësimit të tenderëve ka vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar për këtë aktivitet të prokurimit duke u bazuar edhe në vendimin e OSHP-së 2024/0091 dhe konstaton si në vijim: Oferta e Grupi i operatorëve ekonomik Shala&Associates Sh.P.K, Betim Shala B.I, Avokat Arbër Shala B.I, është ofertë e papërgjegjshme pasi që nuk i është përgjigjur letrës standarde kërkesës për sqarim të dosjes së tenderit për zgjatje të vlefshmërisë së tenderit dhe sigurisë së tenderit brenda afatit të cekur në letrën standarde.

Në rastin konkret ky konstatim i AK-Komisionit është plotësisht i gabuar dhe tendencioz dha ka pasur për qëllim diskriminimin dhe eliminimin e GOE, për faktin se AK-ja **asnjëherë nuk i ka dërguar GOE Shala & Associates letrën standarde për zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, pasi që tek dokumentet letrat standarde figuron garancioni - dëshmia e GOE me të cilën ka bëre zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës dhe nuk figuron letra standarde me të cilën është kërkuar zgjatje e periudhës së garancionit.**

Provë: Dokumentet e kërkuara nga AK-ja në E-prokurim(ku nuk figuron kërkesa për zgjatje të validitetit të ofertës).

Për me tepër Grupi i operatorëve ekonomik Shala&Associates Sh.P.K, Betim Shala B.I, Avokat Arbër Shala B.I, përkundër faktit që **AK-ja asnjëherë nuk ka kërkuar nga GOE që të bëjë zgjatjen e validitetit të ofertës GEO e ka bëre zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës – pa ndërprerje dhe oferta e GOE është e vlefshëm deri më datë 27.06.2024, si dhe dëshmia se GOE e ka bërë zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës është dërguar edhe përmes emalit zyrtar më datë 29.03.2023 dhe është ngarkuar në platformën E-prokurimi më datë 29.2024.**



1 of 11

Titulli: Shërbime për përfaqesime dhe konsulenc ligjore Nr.Prokurimit:TER-023-055-2.2.1

Shala Associates <infoshala.law@gmail.com>
to skender.maqastena, faton.shatmani

Mar 29, 2024, 10:02 AM

Përshëndetje i nderuar,

Bashkangjitur gjeni deklaratën për vazhdimin e validitetit te ofertës dhe sigurinë e tenderit GEO:Shala&Associates Sh.P.K, Avokat Arbër Shala B.I, Avokat Betim Shala B.I, duke u bazuar në faktin që aktiviteti i prokurimit është në proces e sipër.

Gjithashtu duke u bazuar edhe në vendimin e OSHP: 2024/0091, të datës 21.03.2023, pas që ky aktivitet i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim, kërkojmë nga ana juaj që brenda mundësive objektive dhe afatit të paparë ligjor të ndërmerrmi veprime në zbatim të këtij vendimi.

Ju lutem të mos hezitoni të na kontaktoni për çdo paqartësi.

Me Respekt,
Shala&Associates Sh.P.K

2 Attachments • Scanned by Gmail

Deklarate termok...

KS ELsig Siguria e...

Reply | Reply all | Forward

Për më tepër AK-ja nuk e ka shkel nenin 7 të LPP-së, ku edhe pasi i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë por AK ka marr vendim për anulimin e tenderit, ashtu që paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së përcakton se "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente",* po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 parasheh që *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*

Dhe në fund, AK nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Andaj mbi bazën e të lartcekurave japim këtë PROPOZIM

Duke konsideruar që AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara

të LPP-së, dhe akteve nënligjore, ku si pasojnë e shkeljeve të tilla ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga GOE **Shala&Assocates, Betim Shala B.I, Avokat Arbër Shala B.I,** pas që i plotësojmë të gjitha kriteret për dhënien e kontratës, kërkojmë nga AK që të marrë në konsideratë dhe të vlerësoje të gjitha faktet e paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim dhe duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, barazisë dhe mos-diskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje, i propozojmë të merr këtë:

URDHËRESË

APROVOHET SI E BAZUAR, **ANKESA e GOE SHALA&ASSOCATES, BETIM SHALA B.I, AVOKAT ARBËR SHALA B.I.**

ANULOHET Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, të datës 18.04.2024 dhe të TË DETYROHET AK NP TERMOKOS Sh.a– QË TA FTOJ GOE Shala&Assocates, Betim Shala B.I, Avokat Arbër Shala B.I, PËR NËNSHKRIM TË KONTRATËS.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Shpenzimet operative lidhur me përgatitjen e dokumentacionit si dhe na dëmton në fitimin që mund të realizojmë me nënshkrimin e kontratës për këtë aktivitet (fitimi i humbur), si dhe dëmtim i imazhit të kopanisë sonë përballë bashkëpunëtorëve tanë pasi që ne jemi kompani serioze dhe e përgjegjshme për implementimin e shumë kontratave me institucioni publike në Republikën e Kosovës dhe me kompani Private brenda dhe jashtë vendit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*